



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 209, datë 25.11.2021

PËR

**MIRATIMIN E UDHËZIMIT “PËR PROCEDURAT E INSPEKTIMIT NË SUBJEKTET
E MBIKËQYRURA NGA AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2 dhe të nenit 19, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, Ligjit nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”, Ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensionit vullnetar”, Ligjit nr. 66/2020, datë 21.05.2020 “Për tregjet financiare të bazuara në teknologjinë e regjistrave të shpërndarë”, si dhe të Ligjit nr. 32/2021, datë 16.03.2021 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e Udhëzimit “Për procedurat e inspektimit në subjektet e mbikëqyrura nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.**
- 2. Shfuqizimin e Udhëzimit nr. 2, datë 21.11.2007 “Për procedurat e inspektimit në subjektet financiare jo-bankare”.**
- 3. Ngarkohen Departamentet e Mbikëqyrjes në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, për zbatimin e këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**